Nr. 45 prot
Dt. 25/10/2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË**

**VENDIM**

Nr. 34 , datë 20.10.2022

**PËR**

**MIRATIMIN E RINOVIMIT TË LEJES "PËR PËRDORIM BURIMI UJOR SIPËRFAQSOR PËR QËLLIME INDUSTRIALE", SUBJEKTIT "MANTOVANI BETON M.B" sh.p.k**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, "*Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre*", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e rinovimit të lejes nr. prot. 90/35 datë 23.02.2017 për përdorim burimi ujor sipërfaqsor nëpërmjet përroit të Rrencit për qëllime Industriale, larje inertesh dhe prodhim betoni, subjektit "Mantovani Beton M.B" sh.p.k., me vendndodhje Rrencë, Gur i Zi, Shkodër, sipas këtyre koordinatave:

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujor në sistemin KRGJSH janë:

- X =462003
- Y =4657704
- Z=19 m

Sasia e ujit që do të përdoret Q=0.00193 $m^3/s$

Prurja mesatare: Q=0.37 $m^3/s$

3. Burimi ujor të mos përdoret për larje të inerteve lumore nëse subjekti nuk ka një leje aktive të shfrytëzimit të këtyre të fundit.

4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektit.

**KRYETARI I KBU DRIN-BUNË**

**MAJLINDA ANGONI**